



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 98
Prishtinë, më 29.01.2014, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili
Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Komandanti i FSK-së Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati,
Gjeneral Gëzim Hazrolli, Dhurata Kryeziu-OSBE, Luanda Domi- DCAF, Visar Rushiti GAP,
Mentor Vrajolli QKSS, Sanije Berisha OSCE.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Zarife Aliu dhe Antingona Ibraj, Naim Hoxha
OSBE, Avni Arifi CDF.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 21.01.2014;**
3. **Shqyrtimi i Raportit Vjetor të FSK-së për vitin 2013- Raportim i Komandantit të FSK-së, Gjenerallejtënant-Kadri Kastrati;**
4. **Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2014;**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 21.01.2014

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 21.01.2014 u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të FSK-së për vitin 2013- Raportim i Komandantit të FSK-së, Gjenerallejtënant-Kadri Kastrati

Ahmet Isufi- Përshëndetje për Gjeneral Kastratin dhe Gjeneral Hazrollin. Ju falënderoi për prezencën e juaj sot këtu. E keni fjalën që ta prezantoni raportin e vitit 2013 për aktivitetet e FSK-së, pastaj ne si anëtar të komisionit do ti paraqesim komentet dhe pyetjet shtesë për JU. Fjalën e ka Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Faleminderit Kryetar dhe të nderuar anëtar të komisionit. Fillimisht kisha dashur t’u falënderoj për përkrahjen dhe vizitat që na i keni bërë. Përkrahja e juaj na ka motivuar që FSK-ja për herë të dytë të shpallet Institucioni më i besuar në Republikën e Kosovës dhe kjo është falë angazhimit të pjesëtarëve të FSK-së, por një pjesë të meritës e keni edhe Ju si komision që çdo herë keni qenë mbështetës të FSK-së.

Unë sot do ta paraqes raportin të cilin e keni marr edhe në formë të shkruar të cilin do ta elaborojmë me detajishtë sot bashku me Ju.

(Raportin e prezantuar nga Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati, Komisioni e ka në formë të shkruar)

Pyetjet dhe komentet e parashtruara nga anëtarët e komisionit.

Ahmet Isufi- E falënderoj Komandantin e FSK-së për raportimin, unë i kam disa çështje të cila do ti përmendi. Në agjendën legjislative të Qeveris nuk është askund Ministria e FSK-së e paraqitur dhe mendoj se këtë duhet ta rishikoni. E dyta çështje është në lidhje me rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë, është mirë që sa më shumë të jeni të përgatitur në mënyrë që ky rishikim të jetë sa më përmbajtësor dhe ndryshim të pozicionit të FSK-së, në mënyrë që të arriturat e FSK të vlerësohen si nga mekanizmat e brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Po ashtu e kam një kërkesë që ka të bëjë me dominimin në Lug-bunar të Komunës së Gjakovës është një pompë e benzinës Marash petroll, ku gjatë bombardimeve ka pasur goditje në atë pjesë dhe dyshohet se mund të ketë ende mjete shpërthyes dhe mendoj që Ju duhet ta merrni parasysh këtë në mënyrë që të pastrohet tereni.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Faleminderit për komentet, ndërsa sa i përket deminimit, ne e kemi marr këtë kërkesë dhe e kemi shqyrtuar. Por problemi qëndron sepse të gjitha ato lokacione kërkojnë pajisje speciale të cilat Kosova dhe FSK-ja nuk i ka. Por unë në javën e ardhshme kam takim me ambasheun e Suedisë por dhe një vizitë që do ta kem në muajin maj në Suedi, do të kërkoj që të na i huazojnë edhe njëherë këto pajisje speciale për të pastruar atë lokacionet që kanë mbetur ende të pa deminuara. Po ashtu me ne do të punoj edhe KFORI për pastrimin e këtyre lokacioneve që ka edhe ne vendet tjera.

Ganimete Musliu- Ju uroj për përmbylljen me sukses të vitit 2013 dhe po ashtu ju uroj shumë sukses për vitin 2014. Me gëzon shumë fakti që FSK-ja gjithmonë prin sa i përket besueshmërisë, si nga ana e qytetarëve ashtu edhe nga ana e Institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu kisha uruar që ky nivel i besueshmërisë mos ta fusë FSK-në në një guacë të vetë kënaqësisë por ta merr si një motivim për të vazhduar edhe me tutje në realizimin e synimeve dhe objektivave të gjeneratave të mëhershme. Me gëzon fakti që dëgjova se në FSK së shpejti do të kemi një femër Gjeneral, jo pse jam feministe por dua të besoi fuqishëm që në FSK ka gra e vajza të cilat kanë kapacitet për të marr gradën Gjeneral në FSK. Kam një pyetje konkrete. FSK-ja ka akredituar edhe atashetë e pare në stafin diplomatik të Republikës së Kosovës. Andaj dua ta di si janë gjendur dhe cila është performanca e tyre dhe cila është vija komunikuese mes juve dhe atashëve në vendet e akredituara dhe si janë pritur ata nga vendet ku janë të akredituar.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Po e jap një koment rreth femrës në FSK. Unë thash që në synojmë në të ardhmen do ta bëjmë femrën Gjeneral por kjo nuk do të thotë që do ta bëjmë nesër. E cekët që femrat janë të afta. Unë ju them që Manushaqe Nura, e cila ka qenë në mesin e 800 studentëve në Akademinë Mbretërore në Britaninë e Madhe e ka zënë vendin e tretë. Prandaj performanca e femrës në FSK është në nivel të lart. Sa i përket atashëve. Ne deri më tani i kemi tre atashë të akredituar në SHBA, Berlin dhe Bruksel. Detyrat i kryejnë jashtëzakonisht mirë, janë të pranuar si nga ambasadat ashtu edhe nga Ministrit e Mbrojtjes dhe organizatat e atashëve në atë shtet. Fillimisht i kemi pas disa pengesa i kemi pas në Gjermani, kemi pas një qasje pak më të rezervuar por dalëngadalë janë duke u tejkaluar edhe ato pengesa. Jam duke e përgatitur direktivën për ta se si duhet të veprojnë dhe cilat janë interesat ata duhet ti mbrojnë gjatë vitit 2014 dhe tutje. Sipas rregullave tona ata raportojnë drejtpërdrejt në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Siguri, por raportojnë edhe te Ministri i FSK-së. Raportimi i tyre bëhet çdo muaj.

Fatmir Xhelili – Përshëndetje për Gjeneralët. Së pari respekt për punën e juaj personalisht dhe të pjesëtarëve të FSK-së. I kam dy tri pyetje për ju. Në ligjet ekzistuese a keni hasur në ndonjë pengesë të cilat ndikojnë në veprimet e juaja dhe punën e juaj, në mënyrë që të ndërhyrë në përmirësime. E dyta numri i pjesëtarëve ekzistues të FSK-së a është i mjaftueshëm, në bazë të volumit të punës që e keni realizuar këto dy tri vite të fundit. Po ashtu kur është fjala të pajisjet specifike që i përmendet, a e keni në plan që ato pajisje ti huazoni apo ka nevojë që shteti ynë ka nevojë për ti blerë ato pajisje, sigurisht ju i analizoni se a ka nevojë për përdorim afatgjatë apo afatshkurta, se ndoshta do të kemi mundësi të u ndihmojmë për blerjen e atyre pajisjeve normal nëse s'janë tepër të kushtueshme karshi buxhetit.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Sa i përket Ligjeve ekzistuese, janë të përpiluar aq sa që FSK mund ti kryej detyrat dhe obligimet pa asnjë pengesë, por në të ardhmen patjetër që këto Ligje do të na duhet ti plotësojmë dhe ti modifikojmë. Sa i përket numrit të pjesëtarëve të FSK-së, unë me përgjegjësi të plotë them se të gjitha detyrat dhe obligimet që dalin për FSK-në, ky numër është i mjaftueshëm dhe nuk kemi hasur ndonjë pengesë të fuqisë njerëzore gjatë vitit 2013 për ti kryer obligimet dhe detyrimet si ato të rëndomtat, ashtu edhe detyrimet ndërkombëtare që kemi pasur gjatë vitit të kaluar. Pajisjet e specializuara që i kam përmendur, janë të nevojshme për dominimin e terreneve të minuara për eliminimin e tyre dhe pas eliminimit të këtyre rreziqeve me nuk do të na duhen për përdorim, për këtë arsye nuk kemi tentuar që ti blejmë për këtë kemi hasur në mirëkuptim prej miqve tan ndërkombëtar që të na i ofrojmë përkohësisht këto pajisje derisa ta largojmë rrezikun prej qytetarëve të Kosovës.

Rexhep Selimi – Ky raportim është periodik dhe i nevojshëm për anëtarët e komisionit, sepse me këtë edhe ne si ligjvënës mund të vlerësojmë se a e kemi kryer punën tonë mjaftueshëm sa i përket funksionimit normal të FSK-së. Unë e përgëzoj FSK-në për detyrat që i ka kryer dhe unë kisha dashur që FSK të këtë edhe më shumë detyra. Desha të ndërlihem me çështjen e deminimit që e përmendi kryetari. Unë kam kontaktuar drejtpërdrejt me pronarin e pronës së minuar, përveç minimit ajo zonë nuk është as e siguar me shenja për mos futjen e njerëzve në atë pjesë dhe fatmirësisht deri tani nuk ka pasur ndonjë incident. Unë pres që në raportet e 2014 kjo të jetë në raport si e arritur, sepse unë nuk pres që në raport të jetë ndërtimi i një urë në manastirin e Deçanit, sepse çdo ditë një gjë të tillë e shohim në televizion dhe shpresoj që FSK-ja ti tejkaloj këto detyra që i ka bërë deri më tani.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Pajtohem plotësisht dhe e di vendin ku është, por FSK e benë vetëm identifikimin e zonave të rrezikshme, ndërsa pjesa tjetër e mbrojtjes së sigurisë së brendshme për ti kufizuar ato i barten policisë së Kosovës. Prandaj unë do të bisedoj me policinë e Kosovës që ky vend të sigurohet edhe me shumë.

Anton Quni – Përshendetje për të gjithë ju. Për mua është mbresëlënëse raporti që e keni bërë si dhe vlerësimet për punën e juaj si nga autoritetet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare. Nëse keni mundësi na thoni pak më shumë në lidhje me kualitetin dhe shërbimet e kompanive private me të cilat ju keni kontratë, për derivate, infrastrukturë, mirëmbajtje të automjeteve, ushqim etj. A mendoni që kualiteti i këtyre shërbimeve do të rritet nëse kjo kalon në përgjegjësin e juaj nga Ministria e FSK-së.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Unë ka dy vite që e kam nënshkruar konceptin e mirëmbajtjes që në si FSK, dalëngadalë ti marrim disa punë nga operatorët ekonomik të bartet të FSK, siç është mirëmbajtja e automjeteve dhe objekteve. Neve na nevojitet një kohë për ta përgatitur stafin e FSK-së për këtë çështje, ne dalëngadalë do të kalojmë nga operatorët ekonomik të jashtëm tek komanda e logjistikës së FSK-së. Arsyeja e parë është që të kursejmë paranë publike dhe e dyta është që presim që ne si FSK do të marrim pjesë në operacione paqeruajtëse apo humanitare jashtë Republikës së Kosovës dhe ne duhet ti kemi të ngritura këto kapacitete të mirëmbajtjes. Por edhe sa i përket operatorëve ekonomik dua të them se ne nuk kemi pasur telashe të mëdha, të vogla mund të ketë por jo për ta dëmtuar apo për ta penguar punën e FSK-së.

Rasim Demiri - Ju përshëndes të gjithëve e posaçërisht Gjeneral Lejtnant Kadri Kastratin. E patëm rastin ta dëgjojmë një raport të mirë, po ashtu e pamë që FSK ka kryer punën e vet me sukses dhe po ashtu uroj që në 2014 të arrij edhe më shumë suksese. Pyetja është, ka shumë pjesëtar që janë duke u shkolluar jashtë vendit dhe desha ta dijë cilat janë kriteret e selektimit për shkollim të mëtutjeshëm. A mundet shembull dikush që e përfundon shkollën e mesme ta vazhdoj direkt Akademinë apo duhet të kaloj neper ndonjë kurs të Akademisë ushtarake që ta vazhdoj më tutje shkollimin.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Deri më tani përzgjedhjen e kadetëve të cilët shkollohen në Republikën e Maqedonisë dhe në Turqi e kemi bërë drejtpërdrejt nga efektiv i FSK-së, nga ushtarët të cilët janë selektuar dhe i kanë kryer trajnimet bazike dhe me testimet shtesë i ka plotësuar edhe kriteret shtesë të kërkuara dhe pastaj janë dërguar në shkollim jashtë vendit. Në kuadër të kësaj është edhe dëshira e tyre, ne nuk e kemi dërguar asnjëherë dikë në shkollim jashtë vendit pa qenë dëshira e tyre personale. Në të ardhmen do të jemi të detyruar të zgjedhim edhe nga shoqëria civile sepse shpesh nuk kemi mundur të dërgojmë ushtar të mjaftueshëm për shkollim jashtë vendit.

Vjollca Krasniqi – Përshëndetje për te gjithë dhe për Gjeneralet Kastrati dhe Hazrolli. Këtu u than shumë fjalë miradije për punën e juaj dhe sigurisht që ju i meritoni gjitha këto. Unë do ti bëjë disa pyetje. Keni thënë që keni bërë 15 largime nga komisioni disiplinor, do të doja të dija në meny të përgjithshme arsyet e largimit të këtyre personave. E dyta flisni me entuziazëm për performancën e femrës në FSK, por mendoj që përqindja 9.8 nuk është e dëshirueshme as për ju as për ne dhe do të doja të inkurajoja që në të ardhmen kjo përqindje të rritet. Si sfidë e keni paraqitur rishikimin e sektorit të sigurisë, përkatësisht nevojën e implementimit të rekomandimeve që do të dalin nga ky rishikim dhe pritet që ne fillim të shkurtit ju dhe ne do ti kemi këto rekomandime, mirëpo keni than se jeni ballafaquar edhe me mungesë të mjeteve buxhetore dhe a keni bërë ndonjë planifikim se sa ju duhen juve për të zbatuar këtë strategji. Po ashtu keni thënë si sfidë edhe kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve speciale për të cilat nuk ka kompani vendore. Si jeni gjendur deri më tani dhe a keni pas probleme për këto raste. Nga koleget u përmend edhe çështja e deminimit. Ndoshta edhe ju jeni në dijeni që nga pjesa prej nga vij edhe unë, mbi ish kazermën Zahir Pajaziti ka shumë hektar tokë që është e pa punueshme mbi 15 vite pikërisht duke mos guxuar të hyjnë në këtë teren sepse ende ka mjete te pa shpërthyer.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Sa i përket disiplinës ne dekorojmë shumë pjesëtar, mirëpo edhe ndëshkojmë çdonjërin që nuk është në vijat e disiplinës të standardeve. Gjitha shkeljet që bëhen në FSK, bëhen duke e thyer kodin e disiplinës, kodin e veshjes, vonesat, mungesat e paarsyeshme në punë. Nuk kemi pas asnjëherë vepra të rënda apo vepra diskriminuese, pra kryesisht gjitha largimet janë bërë për shkak të shkeljes së kodit disiplinor. Prandaj performanca e FSK-së, nuk do të ishte këtu ku është po të mos ishin këto ndëshkime për arsye se janë pjesë e jetës ushtarake. Sa i përket femrave, ndihmës sekretarja e NATO-s, ka qenë te na kur e kemi bërë një prezantim “femra në FSK”. Ajo na ka lavdëruar dhe na ka thënë se jemi shumë më të mirë se në shumë shtete të NATO-s dhe jemi më të mirët në rajon. Nuk është synim i yni mu ndal këtu, synimi i ynë është ta ngritim dhe ta avancojmë sa më shumë femrën në FSK. Mirëpo duke marr parasysh kulturën tonë ku jetojmë dhe se 15 vite më herët femra ka qenë e pa imagjinueshme në uniform, andaj ne jemi të kënaqur që për koto vite kemi avancuar që femra të jetë sa më shumë prezent në uniform dhe të jetë edhe në operacione njësoi siç kryejnë detyrat

edhe kolegët meshkuj. Sa i përket rishikimit, ne kemi kërkuar buxhet shtesë çdo vit për ti zbatuar rekomandimet e **ECSSAR-it**, andaj shpresojmë që Qeveria do të na përgjigjet pozitivisht në mënyrë që na ti plotësojmë këto detyrime. Kjo është sfidë sepse në të ardhmen ne do ta ndërrojmë misionin, detyrat pajisjet dhe shumë çështje tjera. Sa i përket kalibrimin janë disa pajisje të kërkuar shpëtimit, deminimit dhe pajisje speciale, për të cilat Turqia na ka dal në ndihmë. Kanë ardhur me aeroplan special dhe i kanë marr ato pajisje dhe tash për tash nuk kemi ndonjë problem në lidhje me këto çështje. Sa i përket deminimit edhe Llukari është një pjesë e asaj që e biseduam më herët dhe është zonë që pa pajisje speciale nuk do të mund ti kryejmë ato, por edhe atë pjesë e kemi në projekt tonin në të ardhmen.

Goran Marinkovic - Ju falënderoj për raportin korrekt. Duke ju uruar suksese në të ardhmen. Kam një pyetje për Komandantin e FSK-së. Për vitin 2014, a ekziston plani për pjesëtarët nga komuniteti serb që të kyçen në FSK. Sa regrut nga komuniteti serb planifikoni ti dërgoni për studime jashtë. Përveç rezultateve që keni dhen kam një koment lidhur me komunikimin e juaj me deputet. Sa herë që jam ftuar nga ana e Ministrisë së FSK-së nuk është respektuar Ligji për gjuhët zyrtare, pasi që ftesa dhe raportet më janë dërguar vetëm në gjuhën shqipe. Do të ishte mirë që ta respektoni gjuhën, duke mos dalë nga korniza ligjore.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Ne sipas planit tonë në vitin 2014 e kemi edhe një pjesë të regrutimit të stafit aktiv dhe çdo herë kur bëjmë kampanja të regrutimit ato janë të hapura për të gjithë. Ju e dini që vitin e kaluar kemi bërë një kampanjë të posaçme për komunitetin serb dhe nga 63 aplikacione prej tyre 23 i kanë plotësuar kriteret me sukses dhe sot ata punojnë nëpër njësi. Sa i përket shkollimit, ne kemi hasur vështirësi të mëdha, sepse e kemi vështirë nganjëherë ti bindim që është për të mirë të tyre. Gjithashtu kisha qenë i lumtur kisha pas dëshirë që edhe pjesëtarët nga komuniteti serb ti plotësojnë kriteret që të jenë pjesë e Akademisë ushtarake që ne e kemi në Kosovë, por këtu duhet që minimumi 70% ta njohë gjuhën angleze, sepse studimet janë në gjuhën angleze. Të them të drejtën nga dy mijë dhe mezi që kemi arritur ti selektojmë 10 deri 12 pjesëtar, sepse janë kriteret jashtëzakonisht të vështira për të qenë kadet të FSK-së. Sa i përket gjuhës, unë kam përgatitur një urdhër që do ta lëshoj gjatë kësaj jave që prej 01.03.2014, do të filloj edhe kursi i gjuhës shqipe për pjesëtarët serb kërkesë kjo e vetë pjesëtarëve serb.

Goran Marinkovic - Unë desha të ndërlidhem me ju, në komunën e Graçanicës ne si deputet kemi kontribuar që sa më shumë pjesëtar nga komuniteti serb të aplikojnë që të jenë pjesë e FSK-së. Po ashtu edhe në të ardhmen do të kotribojm në këtë drejtim.

Ganimete Musliu – Unë do të lidhem prapë me çështjen e femrës në FSK, jo pse jam feministe, por u provokova nga ajo që thatë në lidhje me paragjykimin për femrën në uniform në 10 apo 15 viteve të fundit. Por unë konsideroj që janë para 15 viteve ato femra që kanë thyer çdo tabu për femrën në uniform, sepse kemi në luftën e fundit në Kosovë ku shumë femra kanë qenë të rreshtuara në ushtrinë çlirimtare të Kosovës krah për krah me burrat në rrethana të jashtëzakonshme, për të mos u kthyer më herët ku në oden e çdo shqiptari ka qenë e varur fotografia e Shotë Galicës me Azem Bejten e për tu kthyer më poshtë te mbretëresha Teutë e më poshtë. Andaj mendoj se ne si profesionist të thirrëmi në mentalitet dhe paragjykime por ne duhet ta luftojmë çdo paragjykim i cili dëmton imazhin e FSK-së.

Danush Ademi – Përshëndetje për të gjithë juve dhe për Gjeneralët. Kam një pyetje për ju, ne edhe më herët edhe me ministrin Ceku e kemi biseduar që një numër nga komuniteti RAE të jenë pjesë e FSK-së, por është pothuajse hera e tretë që asnjë pjesëtar nga ky komunitet nuk është pranuar. Ku është problemi a është konkurs ky vetëm për komunitetin serb, por ne konkurse thotë që është për gjitha komuniteteve dhe në fund pranohen vetëm nga komuniteti serb, skam asgjë kundër asnjë komuniteti, por ku është problemi. Ne kemi bërë një lobim të madh në komunitetin tonë mirëpo asnjë nuk është pranuar dhe ne si lotues po bëmë në kundërshtim më atë që ju kemi thënë. Edhe pse mbi 60 mijë banor të këtij komuniteti jetojnë në Kosovë.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Ne nuk kemi kufizime për një komunitet apo tjetrin, mirëpo standard i FSK-së, është që çdo pjesëtar duhet ti plotëson gjitha standardet të cilat kërkohen dhe këto kriterë janë jashtëzakonisht kërkuese, sepse ne synojmë të jemi anëtar të NATOS dhe të jemi më të mirë së rajoni, për këtë kërkojmë kualitet dhe kjo nuk ka të bëjë fare me diskriminim ju garantoj.

Danush Ademi – Sa i përket kriterëve na kemi informacione se ata i kanë plotësuar kriteret edhe sa i përket aspektit psiko fizik edhe shkollimit po ashtu kanë arritur edhe poenët e duhura dhe ata nuk janë pranuar dhe nuk e dimë arsyen pse.

Gjeneral Lejtnant Kadri Kastrati – Ne jemi transparent dhe çdo pjesëtar që mendon që ju ka bërë e padrejtë mund të vinë ti shohin rezultatet dhe mund të ankohen në departamentet përkatëse pa problem.

Ahmet Isufi- Konsideroj se e patëm kohen e mjaftueshme për ta dëgjuar Gjeneralin dhe pyetjet e komentet e juaja të nderuar kolegë. Po ashtu konsideroj që FSK-ja, është një institucion vital në Kosovë dhe i vlerësuar si nga institucionet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare dhe se FSK-ja do të vazhdoj të avancohet edhe më tutje me një angazhim shumë më të madh tonin të përbashkët. FSK-ja ka nevojë për përmbushjen e standardeve që kërkohet. Ne ju urojmë sukses edhe në të ardhmen dhe po ashtu që FSK-ja në të ardhmen ta ndryshoj edhe misionin, sepse Kosova duhet të jetë shtet si të gjitha shtetet tjera me institucionet relevante, edhe njëherë ju falënderoj për raportin.

Ahmet Isufi- Ne vazhdojmë me piken e katërt të rendit të ditës. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2014. Planin e punës e keni marr më kohë, ju lus për vërejtjet dhe sugjerimet. Unë përveç disa çështjeve të vogla teknike nuk kam ndonjë vërejtje tjetër. A keni diçka për të shtuar. Po ashtu unë në Strategjinë nuk kam vërejtur që është futur Projektligji për komisionerin e FSK dhe Policisë, dhe nëse pajtoheni propozoj që ti bëjmë një kërkesë zyrës së kryeministrit që ta procedoj projektligjin më tutje.

Raxhep Selimi- Projektligji për Komisioner është projektligj i hartuar me iniciativë parlamentare dhe Qeveria e ka një afat të caktuar kohor dhe sa e di unë ne nuk jemi të obliguar ta presim pas afatit qeverinë dhe nëse duhet ta presim atëherë duhet të kërkojmë siç thatë edhe ju. Nëse nuk kemi nevojë ta presim atëherë ne duhet vet ta procedojmë projektligjin.

Fatmir Xhelili – Unë kam njohuri që në Qeveri është një grup punues që është duke i shqyrtuar gjitha ligjet e posaçërisht ato që kanë të bëjnë me integrimet evropiane, andaj besoj që do ta kemi

edhe këtë ligj shpejt. Mua plani me pëlqej dhe nëse kemi edhe aktivitete shtesë po ashtu do ta kemi të drejtën ti fusim në planin e punës, përndryshe plani është në rregull.

Ganimete Musliu – Unë në aspektin përmbajtjesor pajtona me planin, vetëm e lus administratën pasi që ky dokument është zyrtar ta ketë parasysh anën teknike e gjuhësore sepse ka disa gabime të tilla teknike.

Ahmet Isufi – Po ashtu desha ta cek se në strategjinë legislative është parapa në ministrin e integriteteve Projektligji për përgjimet e telekomunikimeve, mendoj që kjo nuk do të duhej të jetë kështu dhe ka mundësi ti kaloj komisionit për integritete dhe mendoj që do të duhej të kërkojmë një sqarim për këtë. Po ashtu këtu e kemi edhe një propozim nga instituti Gap të cilët kanë një projekt për të cilin do ta bëjnë një raport hulumtues në lidhje me Inspektoratet që bien në fushën tonë, këtu kemi edhe z.Visar Rushiti, por unë nga gjithë ky prezantim kërkoj që të na e sjellin një dokument të shkruar të cilin pastaj do ta diskutojmë bashkërisht. Të nderuar anëtar po e bëjmë një votim formal të planit të punës.

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, e miratuan Planin e punës së komisionit për vitin 2014.

Ahmet Isufi – Në pikën të ndryshme. Ju njoftoj që raporti vjetor për Policinë e Kosovës është publikuar dhe neve ende nuk na ka ardhur, nëse pajtoheni unë kisha kërkuar që deri me 04.02.2014, të na vijë raporti dhe pastaj me datën 10 ta shqyrtojmë. Po ashtu edhe raportin e Inspektoratit të Policisë, që ti shqyrtojmë të dy raportet.

Rexhep Selimi – Nuk e di a do të duhej ti kërkojmë apo të na i sjellin këto raporte ata vet, por e lus administratën të na njoftoj kur të na njoftoj kur të na vij raporti në mënyrë që të kemi kohë për ta shqyrtuar, e di që s'është punë e administratës po nganjëherë derisa sa po i marrim nga kutit po bëhet shumë vonë për shqyrtim, kështu që do të kemi më shumë kohë për ti analizuar. Po ashtu mendoj se do të duhej ti thërrasim edhe drejtorët për raportim.

Ahmet Isufi – Në kuadër të raportit do ti kemi edhe Drejtorin e Policisë dhe drejtorin e Inspektoratit në mënyrë që ti diskutojmë bashkërisht këto raporte.

Ganimete Musliu – Në mbledhjen e fundit kam kërkuar që ta thërrasim një grup të ish pjesëtarëve të TMK-së të pa inkuadrim, për të diskutuar në lidhje me kërkesat e tyre, a keni ndërmarr diçka në lidhje me këtë çështje.

Ahmet Isufi – Ende nuk kam kontaktuar me këta pjesëtar por këto ditë do të kontaktoj dhe do të ju njoftoj. A ka dikush edhe diçka për të shtuar.

Goran Marinkovic – Nuk desha sa ishte Gjenerali ta them këtë sepse sheshta ta prishi atmosferën e punës këtu. Por nganjëherë nuk po mundemi për ta kuptuar se për çka po flitet por kjo është edhe e meta e jonë që po kërkojmë respektimin e ligjit për gjuhët. Por nuk desha të flas për këtë, por unë desha të flas për korrektësinë e punës tonë si deputet, sepse dikush na merr neve si shembull popullin tim se pse dhe si ata duhet të lejohen të jenë pjesë e FSK-së dhe ju nuk

reagoni. Mendoj se këtu ju duhet të reagoni, për arsye se z.Danush nuk është dashur ta merr shembull komunitetin serb pse në konkursin e kaluar ka pasur 26 të punësuar. Nuk është komuniteti serb që ndoshta nuk keni kandidat adekuat. Ju lus që në të ardhmen të na mbroni dhe të jeni korrekt. Po ashtu duhet të reagoj që të mos merret si shembull ura e Manastirit te Deçanit në kontest negativ pasi që dikush ka bërë një punë të mirë.

Ahmet Isufi – Për shkak të korrektësisë, mund të them që në çdo herë kemi kërkuar që gjuha që është e garantuar me ligj të respektohet në të gjitha institucionet. Sa i përket pjesëmarrjes së pakicave e tha edhe Gjenerali është e vullnetit të qytetarit dhe nëse kërkojnë kualitete të tilla që s'mund ti plotësoj një kuadër në s'mund ti bëjmë dhunshëm ato sepse jemi të mbikëqyrur edhe prej NATO-s edhe mekanizmave të tjerë të cilët e bëjnë seleksionimin.

Danush Ademi – Nuk e kam thënë me asnjë qellim por për shkak të raportit, sepse unë e thash nëse është konkursi për komunitetet duhet të jetë për të gjitha komunitetet dhe nëse është vetëm për një komunitet le të jetë vetëm për një komunitet.

Goran Marinkovic – Në raport ceket vetëm sa pjesëtar janë pranuar nga komuniteti serb asgjë më shumë. Po të ishin pranuar edhe nga komunitetet tjera me siguri do të ishte cekur.

Danush Ademi – Pikërisht këtë e kërkoja nga Gjenerali sepse kanë konkurruar edhe nga komuniteti im dhe asnjë nuk është pranuar. Ky është reagimi im sepse ata kandidat i kanë plotësuar kushtet dhe unë i kam edhe shënimet.

Rexhep Selimi – Dy çështje i kam. E para z.Danushi ka të drejt që nëse konkursi është për të gjitha komunitetet atëherë duhet të jetë për të gjitha komunitetet. Unë mendoj që është mirë më hek njëherë e përgjithmonë nga agjendat integrimin e minoriteteve sepse kjo nuk na nderon por që në FSK dhe çdo institucion tjetër të vijnë në shprehje njerëz adekuat me kualifikimet e duhura pavarësisht se çfarë komuniteti kanë. Sa i përket urës vërtet jemi lodhur me këtë rol që i jepet FSK-së. Është mirë me ndërtu urë por jo FSK-ja, atëherë pse FSK nuk thirret për ta ruajtur këtë urë që ka nevojë por për ta ndërtuar, ky është reagimi i im. Kjo s'ka të bëjë pse është e lidhur me minoritete por për shkak se FSK-ja po përdoret për diçka që nuk është e destinuar. FSK-ja nuk është kompani ndërtimi, ato janë punë të komunave dhe jo të FSK-së.

Ganimete Musliu – Dua të lidhem me shqetësimin e Danushit. Me vjen shumë keq që në Kosovë, po paragjykohet komuniteti RAE ku fillimisht unë nuk jam as për këtë emërtim sepse janë tri komunitete që po përfshihen vetëm në tri shkronja ku automatikisht po diskriminohen. Nuk duhet të paragjykohet që nuk ka kuadro nga këto tri komunitete për të marr pjesë në FSK. Unë personalisht kam takuar më shumë se tridhjetë të rinj të këtij komuniteti të cilët ose kanë pasur të përfunduar ose janë duke përfunduar studimet. Prandaj e kisha inkurajuar z.Danush që të shkoj dhe ti verifikoj dokumentet ti trajtoj dhe ti dërgoj në instancat më të larta dhe nëse me të vërtet këtyre komuniteteve ju ka bërë e pa drejt ta ngre shqetësimin në instancat e duhura dhe ne do ta përkrahim. Andaj mos të paragjykohet sepse këto komunitete dita e ditës janë duke u avancuar sa i përket shkollimit.

Ahmet Isufi – Ju lutem ne duhet të kërkojmë nga institucionet ta respektojnë ligjin, ti respektojnë kriteret dhe ti vlerësojnë ata. Ne mund ta vlerësojmë institucionin, ti bëjmë vërejtjet

nëse ka diskriminim, por na duhet me pas ndonjë bazë. Ju lutem të vazhdojmë të punojmë kompakt dhe ashtu siç kemi punuar edhe deri më tani si komision. Ju faleminderit.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi